



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VIII**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Integrim Evropian**

**Mbledhja nr. 42**

**Prishtinë: Dt. 28.07.2022, në orën 10:30**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Rrezarta Krasniqi, Arbëresh Kryeziu Hyseni, Fridon Lala, Agon Batusha, Fjolla Ujkani, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Elmi Reçica, Blerta Deliu Kodra dhe Time Kadrijaj.

**Mungoi:** Branisllav Nikoliq.

**Nga stafi mbështetës i Komisionit:** Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

**Pjesëmarrësit tjerë:** asistentë nga grupet parlamentare, LVV, LDK dhe PDK dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi:** Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit

**Kryetarja** e komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen,

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-111 për Arkivat Shtetërore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputshmërisë me legjislacionin e BE-së;

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-083 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për verërat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për kimikate, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua.

### **2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122 si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

*Rrezarta Krasniqi, kryetare tha se Projektligji nr. 08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, ka për qëllim qartësimin e dispozitave për kontrollin financiar të subjekteve politike në Kosovë.*

Legjislacioni i BE-së në fushën e veprimit të këtij projektligji nuk përmban legjislacioni primar dhe sekondar. Pra, çështjet e rregulluara dhe të adresuara në këtë projektligj nuk janë të mbuluara me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

### **Rekomandim**

*Projektligji nr. 08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256 me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.*

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-111 për Arkivat Shtetërore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, tha se Legjislacioni i BE-së në fushën e veprimit të këtij projektligji nuk përmban legjislacioni primar dhe sekondar. Pra çështjet e rregulluara dhe të adresuara në këtë projektligj nuk janë të mbuluara me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 08/L-111 për Arkivat Shtetërore, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-083 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për verërat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, tha se Legjislacioni i BE-së në fushën e veprimit të këtij projektligji nuk përmban legjislacioni primar dhe sekondar. Pra çështjet e rregulluara dhe të adresuara në këtë projektligj nuk janë të mbuluara me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

#### **Rekomandim**

Projektligjit nr. 08/L-083 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për verërat, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për kimikate, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, tha se Projektligji nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për kimikate, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për kimikate, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

**6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, tha se mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

**Rekomandim**

Projektligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

Takimi përfundoj në orën 10:50.

**Rrezarta Krasniqi,**

-----

**Kryetare e Komisionit**

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit*